

Emri i Subjektit

**RREGULLORE E BRENDSHME
PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE
FINANCIMIN E TERRORIZMIT DHE FINANCIMIN E ARMËVE TË DËMTIMIT
NË MASË**

Neni 1

Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar dhe miratuar nga (Emri i Subjektit _____) në zbatim të:

- Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit”, i ndryshuar;
- Ligjit nr.157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar.
- Ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Udhëzimit nr. 1, datë 21.01.2025 i Ministrit të Financave “Për mënyrat dhe procedurat për zbatim nga subjektet e përfshira në veprimtari financiare”;¹
- Udhëzimit nr. 3, datë 24.01.2025 i Ministrit të Financave “Për mënyrat dhe procedurat për zbatim nga bizneset dhe profesionet e caktuara jo financiare”.

Neni 2

Qëllimi

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i procedurave të brendshme për identifikimin e klientëve, regjistrimin e tyre, mbajtjen e të dhënave, vlerësimin e riskut të klientëve, raportimin e në Agjencinë e Inteligjencës Financiare (AIF), zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare dhe procedurat e tjera që duhen ndjekur për zbatimin e plotë të kuadrit ligjor kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe financimit të armëve të dëmtimit në masë.

Neni 3

Përkufizimet

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë të njëjtin kuptim me përkufizimet e përdorura në ligjin Nr. 9917, datë 19.05.2008, “Për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimin e Terrorizmit”, i ndryshuar, me Udhëzimin nr. ____, datë _____.2025 i Ministrit të Financave Udhëzimin nr. 1 ose 3², të Ministrit të Financave.

¹ Lloji i udhëzimit përcaktohet nga lloji i subjektit raportues

² Lloji i udhëzimit përcaktohet nga lloji i subjektit raportues

Neni 4

Njohja, identifikimi dhe pranimi i klientëve

1. Procedura “Njih klientin tënd”:

a. Subjekti para se të vendosë një marrëdhënie biznesi apo të kryejë një transaksion për një klient, duhet të zbatojë të gjitha procedurat e , identifikimit të tyre dhe verifikimit të identitetit të bazuar në dokumente të identifikimit, të dhënave apo informacioneve të marra nga burime të besueshme dhe të pavarura;. Të dhënat identifikuese të klientit së bashkuar me të dhënat e Vigjilencës së Duhur ruhen në dosje të veçanta për çdo klient

c. Bazuar në Ligjin nr.9917/2008, në kuadrin e procedurës “Njih klientin tënd” dhe nivelit të riskut të pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë (PP/FT/ADM), _____ zbaton një nga nivelet e mëposhtëmeve të vigjilencës për klientët e tij:

Procedura e Vigjilencës së Duhur.

Procedura e Vigjilencës së Thjeshtuar.

Procedura e Vigjilencës së Zgjeruar.

Këto procedura janë përshkruar më hollësisht në këtë rregullore.

Neni 5

Vigjilenca e Duhur

1. Hartimi, miratimi dhe zbatimi efektiv i procedurës “Njih Klientin tënd” përbën aspektin themelor të parandalimit të PP/FT/ADM dhe përfshin tërësinë e masave që ndërmerr _____ , me qëllim identifikimin dhe verifikimin e plotë dhe të saktë të klientëve, pronarit përfitues përfundimtar, strukturës së pronësisë dhe të kontrollit për personat juridikë dhe organizimet ligjore, natyrën dhe qëllimin e transaksionit apo marrëdhënies, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të biznesit dhe të shqyrtimit të vazhdueshëm të transaksioneve, për të siguruar që janë në përputhje me natyrën e biznesit të klientit dhe profilet e rrezikut, duke përfshirë, kur është e nevojshme, burimin e fondeve.

a. Identifikimi Klientit kryhet nëpërmjet dokumenteve personale të tij.

b. Identifikimi pronarit përfitues (personit fizik) dhe verifikimi i këtij identifikimi, në mënyrë që subjekti të krijojë bindjen se kush është pronari përfitues përfundimtar.

c. Identifikimi klientëve bëhet me anë të dokumenteve origjinale të siguruara nga burime të pavarura dhe të besueshme , që janë:

2. Për individët:

a. Letërnjoftim ID.

b. Pasaportë brenda afatit të vlefshmërisë.

3. Për persona juridikë:

a. dokumenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit;

b. vendimi i gjykatës, statuti dhe akti i themelimit, nëse ka;

c. certifikata e regjistrimit të personit të tatueshëm të lëshuar sipas kuadrit ligjor në fuqi ku pasqyrohet numri i NUIS/NIPT;

d. adresa e vendit kryesor të ushtrimit të veprimtarisë, si dhe adresa e degëve të ushtrimit të

veprimtarisë, nëse ka. Dokumente të tjera shtesë, që mund të kërkohen nga subjekti sipas nevojës për identifikim, dhe verifikim të identitetit të klientit janë:

e. Certifikatë, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile.

3. Në rastet kur _____ është i paaftë nuk ka mundësi të zbatojë detyrimin e Vigjilencës së Zgjeruar duhet:

- a. të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojë marrëdhënie biznesi;
- b. Nëse i ka filluar, t'i ndërpresë ato.
- c. Duhet t'i dërgojë raport për aktivitet të dyshimtë në AIF.

Neni 6

Vigjilenca e Zgjeruar

1. Me qëllim zbatimin e Vigjilencës së Zgjeruar, _____ mund të kërkojë praninë fizike të klientit. Në vijim paraqiten kategoritë e klientëve dhe transaksioneve për të cilat _____ zbaton Vigjilencën e Zgjeruar:

a. Personat e ekspozuar politikisht. (PEP)

Nëse një klient është apo bëhet i ekspozuar politikisht para ose gjatë vendosjes së marrëdhënies së biznesit, punonjësit e shoqërisë duhet të kërkojnë informacion në burimet e disponueshme si lista e përditësuar e PEP, vendas, lista e përditësuar nga autoritetet përgjegjëse nga ILDKPKI, etj ;

a.1 Për klientët ose pronarët përfitues të kategorizuar si PEP, kërkohen detyrimisht:

- miratimi i drejtuesit të lartë;
- verifikimi i burimit të fondeve dhe pasurisë;
- monitorimi i shtuar dhe i vazhdueshëm i marrëdhënies së biznesit;
- kërkimi në burime të hapura dhe data baza ndërkombëtare (Worldcheck, Factiva etj.).

a.2 Masat aplikohen edhe për anëtarët e familjes dhe personat e lidhur.

b. Për klientët, të cilët janë organizata jofitimprurëse;

c. Klientët jo rezidentë, të vlerësuar me risk të lartë, veçanërisht për transaksionet që kryhen pa praninë fizike të klientit;

d. Kategoritë e klientëve, të cilët banojnë ose e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në vende për të cilat kërkohet marrja e masave të posaçme, sipas përcaktimeve apo kërkesave të AIF;

e. Klientë organizime ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit, transaksioneve të kryera në emër apo për llogari të tyre, si dhe kur organizimet ligjore apo shoqëritë që kanë aksione të mbajtësit janë pjesë e strukturës së pronësisë, kontrollit apo vendimmarrjes së klientëve të tyre;

f. Për të gjitha transaksionet me vlera të larta, komplekse dhe të pazakonta, që nuk kanë një qëllim të qartë ekonomik ose ligjor;

2. Në rastet kur _____ është i paaftë të zbatojë detyrimin e Vigjilencës së Zgjeruar duhet:

- a. Të mos kryejnë transaksione dhe të mos fillojnë marrëdhënie biznesi;
- b. Nëse i ka filluar, t'i ndërpresë ato.
- c. Duhet t'i dërgojë raport për aktivitet të dyshimtë në AIF.

Neni 7

Analiza e transaksioneve komplekse ose pa qëllim të dukshëm ekonomik

_____ kryen analizë të transaksioneve komplekse, me vlerë të lartë ose të pazakontë. Në kuadrin e këtyre analizave mund të kërkohen dokumente mbështetëse për burimin e fondeve (kontrata, pasqyra financiare, vendime dividendi, kontrata qiraje, vërtetime etj.). Analiza, dokumentacioni mbështetës dhe konkluzionet përkatëse mbahen në dosjen e klientit në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit nr.9917/2008.

Neni 8

Identifikimi elektronik i klientit

1. _____ mund të kryejë identifikimin elektronik të klientit përmes metodave të identifikimit elektronik të sigurt, në përputhje me legjislacionin “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”.
2. Identifikimi elektronik lejohet vetëm nëse:
 - a) verifikohet identiteti me dokument biometrik;
 - b) klienti jo rezident është mbi 18 vjeç;
 - c) klienti nuk ka vendbanimin apo dokumenti i tij i identifikimit nuk është lëshuar nga shtet me rrezik të lartë.
3. Subjekti duhet të vlerësojë paraprakisht rrezikun e kryerjes së identifikimit pa praninë fizike.

Neni 9

Grumbullimi dhe regjistrimi i të dhënave

1. Për çdo klient me të cilin vendoset marrëdhënie biznesi duhet të regjistrohen të dhënat sipas germës “c” të pikës 1 të nenit 11, të ligjit të nr.9917/2008 “Për parandalimin të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
Personi përgjegjës duhet të mundësojë grumbullimin, regjistrimin dhe analizimin e të dhënave në një sistem i cili duhet të përmbajë së paku të dhënat sipas aneksit IV të udhëzimit (1 ose 3) ¹të Ministrit të Financave “Për regjistrimin dhe mbajtjen e të dhënave mbi klientët dhe transaksionet”:
2. Të dhënat duhet të ruhen në format shkresor si dhe të pasqyrohen në format elektronik të përpunueshëm (Excel).

Neni 10

Monitorimi i vazhdueshëm

1. _____ duhet të kryejë monitorim të vazhdueshëm të marrëdhënies së biznesit me klientin. Ky monitorim bëhet për t’u siguruar nëse transaksionet janë në përputhje me njohuritë për klientin, si dhe burimin e fondeve.

¹ Subjekti përcakton sipas rastit udhëzimin përkatës të Ministrit të Financave

2. Ky proces kërkohet të ndërmerret veçanërisht për klientët apo marrëdhëniet e biznesit që kategorizohen me rrezik të lartë dhe duhet të zbatohet menjëherë kur ka arsye për të besuar se situata faktike e klientit ka ndryshuar.
3. Subjekti përditëson dokumentet dhe informacionet e klientit:
 - a) 1 herë në vit për klientët me rrezik të lartë;
 - b) 1 herë në 3 vjet për rrezik të mesëm;
 - c) 1 herë në 5 vjet për rrezik të ulët.
4. Subjekti shqyrton transaksionet e klientëve për përputhshmërinë me profilin e riskut dhe natyrën e veprimtarisë.

Neni 11

Mbështetja në palë të treta

1. _____ mund të mbështetet në palë të treta për kryerjen e masave të vigjilencës së duhur vetëm kur ato plotësojnë kërkesat ligjore për mbikëqyrje, rregullim dhe ruajtjen e të dhënave.
2. _____ duhet të jetë në gjendje të marrë menjëherë nga pala e tretë dokumentacionin e klientit.
3. Ndalohet mbështetja në palë të treta të krijuara në vende me rrezik të lartë.
4. Përgjegjësia ligjore për mosrespektim mbetet gjithmonë e subjektit.

Neni 12

Masat kundër financimit të terrorizmit

Në funksion të zbatimit të ligjit nr. 157/2013, “Për Masat Kundër Financimit të Terrorizmit”, i ndryshuar _____ zbaton masat e mëposhtme.

1. Bazuar në pikën 1, të nenit 10/1, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar, personi përgjegjës _____ ka detyrimin për të siguruar marrjen dijeni dhe përditësimin e vazhdueshëm me aktet e shpalljes nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Personi përgjegjës merr dijeni për këto akte në momentin kur publikohen në faqen zyrtare të strukturave përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Personi përgjegjës gjithashtu regjistrohet në faqen zyrtare të AIF (www.fint.gov.al) për të marrë njoftime mbi përditësimin që bëhen në këto lista. Lista e përditësuar e personave të shpallur shkarkohet nga faqja zyrtare e AIF (www.fiu.gov.al)
2. Personi përgjegjës, verifikon dhe përditëson listën e klientëve ekzistues, menjëherë nga marrja dijeni për aktet e shpalljeve nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara apo të organizatave ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë, për t’u siguruar për të dhëna për fonde apo pasuri të tjera, veprime financiare, transaksione aktuale apo të mbetura në tentativë, si dhe përditëson proceset e brendshme për transaksionet në vijim apo për klientët e ardhshëm.
3. Nëse pas verifikimit sipas pikës 2, të këtij neni, personi përgjegjës konstaton të dhëna për fonde apo pasuri, veprime financiare apo transaksione aktuale ose të mbetura në tentativë

apo raste të përputhjes së akteve të shpalljes me listën e klientëve ekzistues, njofton menjëherë zyrtarisht titullarin, administratorin apo përfaqësuesin ligjor të subjekteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, në varësi të formës së organizimit.

4. Administratori i _____, kur konfirmon plotësimin e kushteve sipas pikës 3, të këtij vendimi, nxjerr menjëherë vendimin e ngrirjes së përkohshme të fondeve apo pasurive të tjera të personit/personave apo entit/enteve të shpallura, pa u kushtëzuar nga nxjerrja e urdhrit të bllokimit të përkohshëm apo vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

5. Vendimi për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo pasurive të tjera përmban të dhënat e mëposhtme:

a) të dhënat identifikuese të personit ose personave apo entit ose enteve të shpallura;

b) përmbledhje të rrethanave të faktit;

c) të gjitha të dhënat në dispozicion për rastin e ngrirjes së përkohshme, përfshirë transaksionet e mbetura në tentativë;

ç) datën dhe vendin e marrjes së vendimit, si dhe periudhën kohore gjatë të cilës vendimi do të ketë fuqi;

d) të dhënat zyrtare të subjektit.

6. _____, njofton AIF në rrugë elektronike dhe shkresore, brenda 24 (njëzet e katër) orëve nga data e nxjerrjes së vendimit për ngrirjen e përkohshme të fondeve apo pasurive të tjera të personave ose enteve të shpallura. _____ zbaton udhëzimet e AIF.

Neni 13

Detyrimet për raportim në lidhje me financimin e terrorizmit

1. Në bazë të nenit 10 “Detyrimi për raportim” të ligjit 157/2013, subjektet e ligjit nr. 9917/2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” duhet të raportojnë në AIF informacione ose dyshime për veprime financiare, transaksione, fonde ose akte të tjera të kryera ose që tentohet të kryhen, që kanë për qëllim kryerjen ose financimin e akteve terroriste pavarësisht nga vlera e tyre.

a. Në çdo rast, raportimi duhet të kryhet menjëherë dhe pa përfshirje të personave të dyshuar ose të tretëve si dhe duhet të përmbajë të dhëna për identifikimin e fondeve e pasurive të tjera, të dhëna në lidhje me pronësinë dhe interesa të lidhura si dhe shpjegime për motivet që mbështesin të dhënat.

b. Duhet të raportohen dhe transaksionet në tentativë, në rastet kur: subjekti ka refuzuar të vendosë marrëdhënie biznesi, klienti vendosë të mos realizojë transaksionin ose për arsye të tjera.

Neni 14

Struktura e brendshme

1. Për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë, _____ ka për detyrë:

- a. Të kontrollojë transaksionet në apo mbi 1,000,000 (një) milion lek në para fizike, apo të barazvlefshmen e tyre në monedhë të huaj.
- b. Transaksionet e dyshimta.
- c. Të caktojë një person përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe armëve të dëmtimit në masë.

Neni 15

Afati për ruajtjen e dokumentacionit

1. Subjekti për qëllimin e kryerjes së transaksioneve duhet të mbajë të ruajë të gjithë dokumentacionin për një periudhë të paktën 5 vjeçare dhe jo më shumë se 40 vjet, të cilat duhet t'i vihen në dispozicion të AIF mbi bazë të një kërkesë të këtij të fundit, jo më vonë se 10 ditë kalendarike.
2. Të dhënat e detyrueshme mbi transaksionet e kryera dhe klientët ruhen në mënyrë të saktë dhe kronologjike që të mundësojë kontrollin nga AIF.
3. Subjekti duhet të ruajë dokumentacionin për identifikimin, llogaritë si dhe kontratat me klientin për 5 vjet nga data e mbylljes së llogarisë apo përfundimit të marrëdhënies të biznesit.

Neni 16

Raportimi i Aktiviteteve të dyshimta tek Autoriteti Përgjegjës

1. Personi Përgjegjës paraqet në AIF raportet për aktivitetin e dyshimtë, në rastet kur dyshon se po kryhet apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale, financim terrorizmi ose fonde që burojnë nga veprimtari kriminale.. Raportimi duhet të kryhet me anë të formularit RAD menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë.
2. Ky raportim kryhet pas shqyrtimit të plotë të elementëve të dyshimtë dhe të dhënave që subjektet kanë në dispozicion për të analizuar dhe arsyetuar, pavarësisht shumës së transaksionit/transaksioneve të kryera, që janë duke u kryer ose do të kryhen.
Përveç raportimit pranë Autoritetit Përgjegjës, gjithashtu subjekti mund të kërkojë udhëzime nëse duhet të kryejë ose jo transaksionin dhe brenda një afati prej 48 orësh nga marrja dijeni.
3. Në rastet kur AIF nuk përgjigjet brenda afatit të parashikuar, _____ vazhdon me kryerjen e transaksionit.
4. Formulari RAD duhet të shoqërohet me të gjithë informacionin e nevojshëm që mbështet dyshimet e parashtruara në raport si: nxjerrjen e llogarive bankare, dokumentacioni i identifikimit, të dhënat e transfertave, kontrata noteriale, etj.
5. Punonjësve të _____ ju ndalohet të informojnë klientin apo çdo person tjetër në lidhje me këtë informacion.

Neni 17

Raportimi i transaksioneve të parasë fizike

1. Personi Përgjegjës i _____ bazuar në nenin 12, pika 3, të ligjit Nr.9917/2008 është i detyruar të raportojë tek AIF brenda ditës pasardhëse të punës nga data e kryerjes, të gjitha transaksionet në para fizike, në një vlerë të barabartë ose me të madhe se 1.000.000 (një milion)

lek ose kundërvlerën në monedha të tjera të huaja, kryer si një transaksion i vetëm ose në disa transaksione të lidhura me njëra-tjetrën brenda 24 orëve.

2. Në funksion të zbatimit të këtij neni, çdo transaksion i cili nuk është i shoqëruar me një dokumentacion justifikues bankar, do të konsiderohet i kryer në para fizike.

Neni 18

Zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë

1. _____ është i detyruar të zbatojë menjëherë dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa e kushtëzuar procesin me miratimin e akteve të mëtejshme nënligjore brenda vendit, bllokimin e përkohshëm të çdo veprimi, ndërmjetësimi, transaksioni, transferte, shërbimi financiar apo të tjera të lidhura, fonde dhe pasuri të tjera, nga momenti i marrjes dijeni për vendosjen, zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, sipas përcaktimeve të këtij ligji.

2. Bllokimi i përkohshëm, sipas pikës 1, të këtij neni, zbatohet në çdo rast kur subjekti i shpallur ushtron të drejta pronësie, kontrolli, me prokurë ose të drejta apo interesa të tjerë, pavarësisht nga fakti se kush i ka në zotërim apo në përdorim fondet apo pasuritë e tjera, sikurse edhe për çdo fond e pasuri tjetër, që është gjetur në posedim ose mbahet nga subjektet e shpallura.

3. Ndalohet njoftimi paraprak i subjekteve të shpallura, të interesuara apo prekura nga bllokimi i përkohshëm.

4. Të dhënat e plota për rastet e bllokuara, sipas pikës 1 të këtij neni, përfshirë transaksionet e mbetura në tentativë, i njoftohen menjëherë organit përgjegjës në përputhje me fushën e tij të përgjegjësisë, duke kërkuar udhëzime nëse duhet të kryhen apo jo transaksione apo të kryhen veprime të mëtejshme. Organi përgjegjës kryen verifikimet përkatëse dhe u kthen përgjigje subjekteve të pikës 1 të këtij neni brenda 48 orëve.

Vendimet e organeve përgjegjëse dhe subjekteve të tjera zbatuese në Republikën e Shqipërisë kanë fuqi të drejtpërdrejtë, të menjëhershme dhe kanë vlefshmëri për një periudhë jo më shumë se 30 ditë pune, duke filluar nga dita e parë pas marrjes së udhëzimeve sipas pikës 4 të këtij neni.

Neni 19

Auditimi i brendshëm

Subjekti duhet të ngarkojnë kontrollin e brendshëm për të kontrolluar përputhshmërinë me detyrimet e zbatimit të kuadrit rregullativ dhe procedurave dhe të përpilojë raportet përkatëse bazuar në standardet e Auditimit të Brendshëm. Këto raporte janë objekt kontrolli gjatë inspektimeve nga AIF, apo organe të tjera të ngarkuara me ligj.¹

¹ Në rastet kur subjektet raportuese janë të vetëpunësuar ose të cilët nuk kanë të punësuar persona të tjerë, për efekt të zbatimit të këtij neni në rregullore përcaktohet që administratori apo i autorizuari prej tij veprojnë në cilësinë e kontrollit të brendshëm.

Neni 20

Vlerësimi i riskut

1. Detyrimet ligjore në fushën e PP/FT/ADM zbatohen në sajë të qasjes me bazë risku e cila nënkupton procesin i cili mundëson identifikimin e rreziqeve të mundshme për PP/FT/ADM si dhe përcaktimin nga _____ të masave për t'i administruar ato në mënyrë efektive.
2. Për të mundësuar një vlerësim risku sa më të plotë e gjithëpërfshirës duhet të merret në konsideratë një vlerësim kombëtar të riskut si dhe vlerësime sektoriale të kryera në përputhje me aktivitetin e kryer nga vetë subjekti.
3. Rreziku vlerësohet për kategoritë Klienti;
 - a) rreziku i klientit;
 - b) rreziku i produktit/shërbimit;
 - c) rreziku gjeografik.
- 3.1 Subjekti përdor metodologjinë e pikëzimit (i ulët, i mesëm ose i lartë).
- 3.2 Klientët me rrezik të lartë rishikohen çdo 12 muaj.

Neni 21

Bashkëpunimi me Autoritetin Përgjegjës

1. Subjekti përgjigjet ndaj kërkesave të AIF brenda 10 ditëve kalendarike.
2. Përgjigjet për kërkesat urgjente trajtohen brenda afateve të përcaktuara nga AIF.
3. Personi përgjegjës koordinon dorëzimin e dokumentacionit.

Neni 22

Trajnimi i punonjësve

1. Subjekti siguron trajnim të specializuar fillestar dhe periodik për të gjithë punonjësit e përfshirë në proceset e PP/FT/ADM.
2. Trajnimet duhet të dokumentohen me listë pjesëmarrjeje, datë zhvillimi dhe tematika.

Administratori
